



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr. 533/2018

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Mevlide Shabani, me bashkëpunëtoren profesionale Gentiana Shabani, duke vendosur në procedurën kontestimore sipas padisë së paditësit Sh. B. nga fsh.Cërnicë, Komuna e Gjilanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. Masar Morina nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit–Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor Burim Maliqi nga Gjilani, për kompenzimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse në pension, pas mbajtjes së seancës gjyqësore dhe publike me datën 14.01.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar me ligj kërkesëpadia e paditësit Sh. B. nga fsh. Cërnicë, Komuna e Gjilanit dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Arsimit në Gjilan, që paditësit t’ia paguaj tri paga për përcjellje në pension në shumën prej **1,357.29 €** (njëmijëetreqindpesëdhjetëeshtatë eurio e njëzetënëntë cent) dhe një pagë në emër të shpërblimit jubilar në shumën prej **210.50 €** (dyqindëdhjetë euro e pesëdhjetë cent), e gjithsej shumën e përgjithshme prej **1,567.79 €** (njëmijëepesëqindëgjashtëdhjetëeshtatë euro e shtatëdhjetëenëntë cent), me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 05.06.2018 si datë e paraqitjes së padisë në këtë gjykatë, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit e kërkuar në emër të shpërblimit jubilar në lartësi prej **1,146.79 €**, e kërkuar më shumë se shuma e gjykuar, **refuzohet si e pabazuar me ligj.**

III. Detyrohet e paditura që t’ia kompensoj paditësit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej **279.00 €**, në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi në këtë gjykatë përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, ka paraqitur padi ndaj të paditurës për kompenzimin e pagave në emër të shpërblimit jubilar t’ia paguaj 3 paga nga 452,43 euro që kapin shumën e prej 1,357.29 € dhe për përcjellje në pension 3 paga nga 452.43 € që

kapin shumë prej 1,357.29 €, të gjitha këto në vlerë të përgjithshme prej 2,714.58 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë, poashtu ka kërkuar që t'ia paguaj edhe shpenzimet e procedurës edhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej 104 €, për 1 seancë të përfaqësuar shumë prej 135 € si dhe shumë prej 40 për taksën gjyqësore për padi, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit t'a aprovoj në tërësi si të bazuar në ligj.

Pas pranimit të padisë, kjo gjykatë duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur ia ka dërguar Aktvendimin për përgjigje në padi së bashku me shkresat e lëndës, në mënyrë që e njëjta të paraqesë përgjigje lidhur me pretendimet e paditësit, njëkohësisht duke e paralajmëruar të paditurën, që nëse brenda afatit të paraparë ligjor nuk përgjigjet, gjykata do të merr aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë-mosbindjes, nëse plotësohen kushtet ligjore. Përfaqësuesi i palës së paditur, përmes përgjigjes së dhënë në padi më datën 28.08.2018, ka theksuar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke u arsyetuar se Kontrata Kolektive nuk prodhon efekt juridik dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunës së Gjilanit dhe se kjo kontratë nuk është në fuqi. Poashtu, i njëjti në shqyrtimin gjyqësor dhe fjalën përfundimtare¹ ka mbetur në tërësi pranë përgjegjes në padi të paraqitur në këtë gjykatë, duke e kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, si dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit t'a refuzoj në tërësi si të pabazuar në ligj.

Me qëllim të vërtetimit të fakteve të paraqitura në padi dhe pretendimeve të paditurës, Gjykata ka lexuar dhe administruar si prova materiale:

Përgjegja në kërkesë me nr. 39969, e dt. 03.05.2018, e lëshuar nga Komuna e Gjilanit; Vërtetimi mbi marrëdhënien e punës me nr. 49, i dt. 22.05.2018, i lëshuar nga SHFMU "Ramiz Cërnica" në Cërnica dhe në paralelet e ndara fizike në Gumnishtë dhe Kravaricë; Vendimi i datës 23.04.2018, i lëshuar nga Departamenti i Pesioneve; Vërtetimi me numër 36, datës 13.04.2018 mbi përvojën e punës e lëshuar nga e njëjta shkollë; Qarkullimi i llogarisë në NLB Bank për periudhën 01.01.2018 deri më dt. 30.08.2018; Aktvendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me numër 37191, i dt. 17.04.2018, e lëshuar nga DKA në Gjilan.

Pas vlerësimit të provave të administruara si dhe provave të paraqitura, në kuptim të dispozitës së nenit 8 të LPK-ës, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Nga Vërtetimi mbi marrëdhënien e punës me nr. 49, i dt. 22.05.2018, i lëshuar nga SH.F.M.U "Ramiz Cërnica" në Cërnica dhe në paralelet e ndara fizike në Gumnishtë dhe Kravaricë, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në këtë shkollë si mësimdhënës i mësimit lëndor "Edukatë Qytetare" e të cilit për shkak të fuqisë së ligjit-arritjes së moshës së pensionimit prej 65 vjeç, i'u është ndërprerë marrëdhënia e punës, më datën 15.04.2018 ashtu siç vërtetohet edhe nga Aktvendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me numër 37191, i dt. 17.04.2018, e lëshuar nga DKA në Gjilan.

¹ Përfaqësuesi i të paditurës Burim Maliqi, fjalën përfundimtare e ka dorëzuar në formë të shkruar më dt. 15.01.2019.

Sipas përmbajtjes së Vërtetimit me numër 36, datës 13.04.2018 mbi përvojën e punës e lëshuar nga SH.F.M.U “Ramiz Cërnica” në Cërnica dhe në paralelet e ndara fizike në Gumnishtë dhe Kravaricë, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka punuar në këtë shkollë si mësimdhënës i mësimi lëndor nga data 01.07.2003 e deri më datën 15.04.2018 dhe ka gjithsej përvojë të punës në këtë shkollë **14 vite e 9 muaj e 14 ditë**.

Nga Përgjegjja në kërkesë me nr. 39969, e dt. 03.05.2018, e lëshuar nga Komuna e Gjilanit, gjykata vërtetoi faktin se e paditura ka theksuar se ekzekutimin e pagave e bënë Ministria e Financave, gjegjësisht divizioni i pagave në kuadër të kësaj ministrie dhe se për shkak se ende nuk është duke u zbatuar Kontrata Kolektive për sa i përket këtyre pagesave, ministria nuk po i ekzekuton asnjë pagesë e në rastin konkret pagesat pas pensionimit.

Ndërsa bazuar nga Qarkullimi i llogarisë në NLB Bank për periudhën 01.01.2018 deri më dt. 30.08.2018 në emër të paditësit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka realizuar të ardhura personale neto për muajt janar 453.31 €, për muajin shkurt 452.43 € dhe mars të vitit 2018 pagën prej 452.43 €, kurse paga bazë e paditësit është 421 €, në muaj.

Andaj, gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike të shpjeguar si më lartë ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar pjesërisht, pasi që nga provat e administruara u vërtetua se paditësi ka të drejtën e kompenzimit në emër të shpërblimit jubilar të një page në vlerë të 50 % të një page bazë të punëtorit si dhe të drejtën e kompensimit të tri pagave për përcjellje në pension në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, duke u mbështetur në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, përkatësisht në nenin 35 paragrafi 8, pika 8.1 dhe paragrafit 9, si dhe nenit 48 po të njëjtes kontratë, pasi që paditësit bazuar nga Aktvendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, i është ndërprerë marrëdhënia e punës sipas fuqisë së ligjit (pensionimit) më datën 15.04.2018, në kohën kur dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive kanë qenë në fuqi. Pra, sipas dispozitës së lartcekur gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit i takojnë tri paga për përcjellje në pension në shumën prej 1,357.29 € dhe një pagë në lartësin e një page bazë për shpërblimin jubilar në vlerë të 50 % në shumë prej 210.50, e gjithsej shumën e përgjithshme prej 1,567.79 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, kjo për faktin se paditësi me rastin e pensionimit tek e paditura ka pasur përvojë pune 14 vite e 9 muaj e 14 ditë, e që sipas nenit 35 paragrafi 8, pika 8.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me të cilën parashihet se “ ***Punëorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë” për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50 % të një page bazë***”, të njëjtit pra, sipas përvojës së punës të arritur tek e paditura i takon një pagë bazë në vlerë prej 50 % të një page bazë, prandaj edhe ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Gjykata e refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit në lartësi prej 1,146.79 €, €, e kërkuar më shumë se shuma e gjykuar të kërkuar në emër të tre pagave të fundit mesatare në emër të shpërblimit jubilar, nga fakti se në nenin 35 pika 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është përcaktuar se “***Punëorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë” për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50 % të një page bazë***, ashtu që konform listës së pagave, pasqyrat bankare paga bazë e paditësit në tre muajtë e fundit ka qenë (për muajin nëntor 421 €, e në rastin konkret gjykata ka vepruar duke e kalkuluar shumën e një page bazë prej 421 € dhe duke e pjesëtuar me

me 50 % e asaj page, ndërsa paditësi në kërkesat e tij ka kërkuar kompensimin e tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të paditësit, e që sipas dispozitës së lartcekur punëtori duhet të paguhet në emër të shpërblimit jubilar me një paga bazë në shumën e 50% të pagës bazë, çka në rastin konkret gjykata pjesën tjetër të kërkesëpadisë të kërkuar më shumë se gjykuar e ka refuzuar, ashtu siç ka vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës për bazën ligjore të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, ku kjo gjykatë erdhi në përfundim se Kontrata Kolektive e cila ka hyrë në fuqi më datë 18.04.2017, paraqet bazë ligjore për themelësinë e kërkesëpadisë së paditësit, pasi që Marrëveshja Kolektive e Arsimit në Kosovë, rregullon të drejtën në pension bazë dhe që Ligji i Punës i Kosovës, shprehimisht nuk parasheh me ndonjë dispozitë ligjore kompensimin e pagave dhe shpërblimit jubilar çka edhe rrjedhë përfundimi se kërkesëpadia e paditësit ka mbështetje ligjore dhe si e tillë është aprovuar pjesërisht si e bazuar në ligj (Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës e dt.18.04.2017), e që në nenin 48 të kësaj kontrate shprehimisht thuhet se *“Me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate shfuqizohet Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar në mes të MASHT-it dhe SBASHK-ut, nr.01B-2200, datë 11.04.2014”*, çka e njëjta paraqet bazë ligjore për realizimin e të ardhurave personale pas pensionimit.

Gjykata vendosi që konform nenit 452.1 të LPK-ës, t’ a detyroj palën e paditur që t’ ia kompensoj palës paditëse shpenzimet e procedurës kontestimore edhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej 104 €, për një seancë të mbajtur shumë prej 135 € si dhe për taksën gjyqësore për padi shumë prej 40 euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 279 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, pasi që vet e paditura me veprimet e saja duke kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, e ka detyruar paditësin në këto shpenzime gjyqësore.

Nga të lartcekurat, e konform nenit 35 paragrafi 8 pika 8.1 dhe paragrafit 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017, si dhe nenit 143 të LPK-së, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr. 533/2018, dt. 14.01.2019

Gjyqtarja,
Mevlide Shabani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh pas pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, ndërsa ankesa dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.